



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MJEDISIT  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE MJEDISORE DHE JETËSIMIT TË  
PRIORITETEVE  
DREJTORIA E BIODIVERSITETIT DHE ZONA VE TË MBROJTURA

Nr. 983 Prot.

Tiranë, më 11.2.2016

UDHËZIM

Nr. 01, datë 11.2 2016

PËR MIRATIMIN E METODIKAVE TË REGJISTRIMIT DHE INVENTARIZIMIT TË  
LLOJEVE TË FAUNËS SË EGËR OBJEKT GJUETIE DHE POPULLATAVE TË  
TYRE, SI DHE FORMATI I DOKUMENTIT, KU PASQYROHEN TË DHËNAT DHE  
REZULTATET E INVENTARIZIMIT

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të nenit 55, pika 4 të ligjit nr. 10253, datë 11.3.2010 "Për gjuetinë",

UDHËZOJ:

1. Miratimin e metodikave të regjistrimit dhe inventarizimit të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie dhe popullatave të tyre, si dhe formati i dokumentit ku pasqyrohen të dhënat dhe rezultatet e inventarizimit për këto lloje, sipas aneksit që i bashkëlidhet këtij Udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Procesi i inventarizimit organizohet e drejtohet nga Ministria e Mjedisit me pjesëmarrjen e instituteve kërkimore-shkencore, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, Bashkive, OJF-ve e të shoqatave që mbulojnë fushën e biodiversitetit dhe të shoqatave të gjuetarëve.
3. Për zbatimin e këtij Udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

